

Politika e shpërblimit

Politika e shpërblimit e Bankës Amerikane të Investimeve SHA është në përputhje me kërkesat e rregullatorëve lokalë. Qëllimi i kësaj politike është të pajtojë kërkesat e një tregu gjithnjë e më konkurrues me pritshmërite legjitime të bankës, stafit dhe klientëve, në mënyrë që të lejojë bankën për të shkuar sa më larg të jetë e mundur me aspiratat e saj dhe të vazhdojë të mishërojë vlerat të drejtësisë, humanizmit dhe meritës të cilat kanë ndihmuar për të ndërtuar suksesin dhe reputacionin e saj. Eshte në politikat e Bankës Amerikane të Investimeve kompensimi i të gjithë punonjësve në një bazë të drejtë dhe të barabartë për punën që ata kryejnë bazuar në një sistem të përcaktimit të objektivave dhe vlerësimit individual të performancës.

Komponentët e shpërblimit janë:

- Paga bazë – shpërblen stafin për aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të lidhura me pozicionet që atyre u janë besuar. Karakteristikat e një pozicioni janë: roli dhe kontributet, niveli brenda organizatës dhe profili i pritshëm në lidhje me aftësitë dhe eksperiencën.
- Shpërblimi i Ndryshueshëm- shpërblen performancën e punonjësit dhe përbën një pjesë integrale të shpërblimit të tij vjetor. Ai është projektuar për të kompensuar punonjësit në përputhje me objektivat e përcaktuara për vitin, performancën e tyre individuale në vitin përkatës dhe performancën e përgjithshme bankës. Në rast performance të dobët, kjo pjesë mund të mos paguhet.
- Përfitimet -të gjitha përfitimet e tjera ne forme jomonetare që i jepen stafit të cilat synojnë rritjen e aftësisë së bankes për mbajtjen e punonjësve.